

UNIVERSITETI “HAXHI ZEKA”

FAKULTETI I MENAXHIMIT NË TURIZËM, HOTELIERI DHE MJEDIS



PUNIM DIPLOME

NDOTJA E MJEDISIT NË KOSOVË

Mentori:

Prof. Dr. Adem Dreshaj

Kandidati:

Vlorentina Dedushaj

Pejë, Nëntor 2024

UNIVERSITETI “HAXHI ZEKA” PEJË
FAKULTETI I MENAXHIMIT NË TURIZËM, HOTELIERI DHE MJEDIS

Departamenti: Menaxhim Mjedis



Student: Vlorentina Dedushaj

NDOTJA E MJEDISIT NË KOSOVË

(Studime të nivelit Bachelor)

Anëtarët e komisionit para të cilëve do të mbrohet punimi:

1. Kryetar: Prof. Dr. Mimoza Hyseni
2. Mentor: Prof. Dr. Adem Dreshaj
3. Anëtar: Prof. Ass. Dr. Osman Sejfiqaj

Pejë, Nëntor 2024

UNIVERSITETI “HAXHI ZEKA” PEJË

FAKULTETI I MENAXHIMIT NË TURIZËM, HOTELIERI DHE MJEDIS



PUNIM DIPLOME BACHELOR

Tema e punimit:

Ndotja e mjedisit në Kosovë

Emri dhe mbiemri i studentit:	Vlorentina Dedushaj
Statusi i studentit:	E rregullt
Numri i amzës:	310662020
Departamenti:	Menaxhim Mjedis
Shkalla e studimit:	Bachelor
Mentori i punimit:	Prof. Dr. Adem Dreshaj

Pejë, Nëntor 2024

ABSTRAKT

Kjo temë shqyrton situatën aktuale të ndotjes së mjedisit në Kosovë, duke përfshirë burimet, pasojat dhe masat e nevojshme për përmirësim. Ndotja ajrore, ujore dhe tokësore paraqiten si probleme kryesore, të shkaktuara nga aktivitetet njerëzore dhe industriale. Analiza tregon se këto faktorë kanë ndikim të drejtpërdrejt në shëndetin publik, biodiversitetin dhe zhvillimin ekonomik.

Si instrument kryesor i hulumtimit ka qenë pyetësi me 15 pyetje më përgjigje opsionale.

Përmes metodologjisë së hulumtimit, studimi ofron rekomandime më të qëndrueshme dhe ndihmon në ndjekjen e standardeve ndërkombëtare të mjedisit, që do të kontribuonte në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe ruajtjen e resurseve natyrore për brezat e ardhshëm.

DEKLARATË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se punimi me titullin “NDOTJA E MJEDISIT NË KOSOVË” është i shkruar nga unë dhe asnjëherë nuk është prezantuar në një institucion tjetër për vlerësim.

Punimi nuk përmban material të shkruar nga një person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Nënshkrimi i studentit:

Pejë, më: _____

FALENDERIME

Së pari falënderimi i takon Zotit për vullnetin, shëndetin dhe çdo mirësi që të arrijë sukses dhe të përfundoj studimet.

Një Falënderim i veçantë për familjen time që këto 3 vite më motivuan, këshilluan, shtynë dhe ndihmuan për ti përfunduar studimet pas të gjitha sfidave të tejkaluara, u jam mirënjohëse tërë jetën.

Falënderim dhe mirënjohje ndaj mentorit tim, të nderuarin Prof. Dr. Adem Dreshaj për motivimin dhe këshillat për përfundimin e temës.

Përmbajtja

Tabela e Figurave	8
Tabela e Grafikoneve	8
1. Hyrja	9
2. Ndotja e mjedisit në Kosovë	9
3. Ndotësit e mjedisit	10
4. Ndotja nga mbeturinat	10
4.1 Ligji për mbeturinat, i ndanë mbeturinat në 4 lloje/grupe kryesore	11
4.1.1 Mbeturinat komunale	11
4.1.2 Mbeturinat komerciale	11
4.1.3 Mbeturinat industrial	11
4.1.4 Mbeturinat medicinale	11
4.2 Legjislacioni	11
4.3 Grumbulluesit e mbeturinave	12
4.4 Deponitë	13
4.4.1. Deponitë ilegale	13
5. Ndotja e ajrit	13
6. Ndotja e ujit	14
7. Ndotja e tokës	15
8. Mbrojtja e mjedisit nga ndotja	15
9. Parandalimi i ndotjes së mjedisit	16
10. Metodologjia e hulumtimit	16
11. Rezultatet e hulumtimit	17
12. Diskutimi i rezultateve	24
13. Përfundime dhe rekomandime	25
14. Referencat	26

Tabela e Figurave

Figura 1. Operatorët që ofrojnë shërbimet e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë (CEDE KS, n.d.) 12

Tabela e Grafikeve

Grafikoni 1.....	17
Grafikoni 2.....	17
Grafikoni 3.....	18
Grafikoni 4.....	18
Grafikoni 5.....	19
Grafikoni 6.....	19
Grafikoni 7.....	20
Grafikoni 8.....	20
Grafikoni 9.....	21
Grafikoni 10.....	21
Grafikoni 11.....	22
Grafikoni 12.....	22
Grafikoni 13.....	23
Grafikoni 14.....	23
Grafikoni 15.....	24

1. Hyrja

Ndotja e mjedisit është një problem i rëndësishëm që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës dhe shëndetin e qytetarëve në Kosovë. Paslufta, vendi ka përjetuar një rritje të shpejtë ekonomike dhe industriale, por kjo ka sjellë gjithashtu pasiguri të mëdha për mjedisin. Aktivitetet industriale, ndërtimi i infrastrukturës dhe menaxhimi i dobët i mbetjeve kanë kontribuar në ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës. Shëndeti i qytetarëve, biodiversiteti dhe cilësia e jetës në Kosovë po rrezikohen nga këto probleme. Një numër studimesh të mëparshme kanë identifikuar pasojat negative të ndotjes, por ende mungojnë zgjidhje të qëndrueshme dhe politika efektive për të adresuar këto sfida. Kjo situatë kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe angazhim nga të gjitha nivelet e shoqërisë, duke përfshirë qeverinë, organizatat joqeveritare dhe qytetarët. Në këtë kontekst, është e nevojshme një analizë e thellë e faktorëve që kontribuojnë në ndotjen e mjedisit në Kosovë dhe ndikimit të saj. Ky studim do të shqyrtojë burimet e ndotjes, pasojat që ajo sjell dhe do të ofrojë rekomandime për masa të qëndrueshme që mund të ndihmojnë në përmirësimin e situatës mjedisore dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

2. Ndotja e mjedisit në Kosovë

“Në përgjithësi ndotja në Kosovë është në nivel të madh dhe situata shëndetësore dhe mjedisore nuk është aspak e mirë” (Bektashi)

Ndotja e mjedisit në Kosovë, përveç që shkaktohet nga kompanitë e mëdha të industrisë së rëndë, vjen edhe nga numri i madh i veturave. Kosova është duke u përballuar me ndotje të madhe të ajrit, ujërave dhe tokave. Qytetarët e Kosovës po kërcënohen nga mjedisi i ndotur. Ndotja e mjedisit ka ndikim negativ në shëndetin e individit qoftë në shfaqjen e sëmundjeve të ndryshme që janë kryesisht të rrugëve të sipërme dhe të poshtme të traktit respirator të zemrës, enëve të gjakut dhe gjithsesi ndikon edhe në shfaqjen e vdekjeve të parakohshme të individëve, duke përfshirë këtu edhe punëtorët të cilët punojnë në këto industri. Ndotja e mjedisit në Kosovë, vjen edhe nga numri i madh i veturave. Në Kosovë llogaritet të jenë afër 385 mijë vetura, ku mesatarja e vjetërsisë së tyre që qarkullojnë në Kosovë është 18 vite.

3. Ndotësit e mjedisit

Përcaktimi i ndotjes sipas shkalles së degradimit të ndotësve në mjedis.

Nga ky këndvështrimi ndotësit i ndajmë në

- të padegradueshëm,
- të degradueshëm.

Sipas natyrës së mjediseve që ndoten:

- ndotjen e ajrit,
- ndotjen e tokës
- ndotjen e ujit

Sipas natyrës fiziko-kimike të ndotësve, ndotje nga:

- dioksidi i karbonit,
- përbërjet e squfurit,
- metani
- përbërjet e azotuar
- ndotja radioaktive,
- ndotja akustike

(Velesin Peçuli, Albert Kopali, 2016)

4. Ndotja nga mbeturinat

Ambienti në Kosovë është shumë i ndotur nga mbeturinat që hidhen vend e pa vend. Mbeturinat janë një prej ndotësve kryesorë të mjedisit në të cilin jetojmë. Ato krijohen nga aktiviteti ditor i individëve, familjeve, bizneseve dhe gjeneruesve të ndryshëm. Menaxhimi jo-adekuat i mbeturinave shkakton rreziqe serioze për shëndetin e njeriut, mjedisin dhe jetesën në përgjithësi. Për të eliminuar këto rreziqe, është e nevojshme të krijohen sisteme për menaxhimin e mbeturinave.

4.1 Ligji për mbeturinat, i ndanë mbeturinat në 4 lloje/grupe kryesore

4.1.1 Mbeturinat komunale

Mbeturinat komunale përfshijnë mbeturinat nga amvisëritë, dhe mbeturinat nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.

4.1.2 Mbeturinat komerciale

Mbeturinat komerciale janë mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industrial.

4.1.3 Mbeturinat industrial

Mbeturinat Industriale janë mbeturinat të cilat krijohen nga aktivitetet, proceset industriale, prodhimtari artizanale dhe veprimtari tjera prodhuese;

4.1.4 Mbeturinat medicinale

Mbeturinat medicinale përfshijnë mbeturinat të cilat krijohen gjatë kryerjes së shërbimeve medicinale;

4.2 Legjislacioni

Në Kosovë, sipas Ligjit mbi Mbeturinat, përmes Nenit 15, menaxhimi i mbeturinave është kompetencë e komunave, nëpërmjet zhvillimit të mekanizmave të planifikimit lokal, krijimit të sistemit të nevojshëm dhe sigurimit të zbatimit të tyre përmes departamenteve të shërbimeve publike dhe inspektorateve komunale.

Sipas Ligjit, dokumentet kryesore për planifikim dhe menaxhim të mbeturinave janë:

- Strategjia e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave,
- Plani i Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave,
- Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave,
- Planet për menaxhimin e mbeturinave nga zotëruesit e mbeturinave dhe Planet për menaxhimin e mbeturinave nga personat e licencuar.

4.3 Grumbulluesit e mbeturinave

Në Kosovë, mbeturinat grumbullohen nëpërmjet operatorëve publikë, privat, në bazë të marrëveshjeve të partneritetit publiko-privat, apo edhe nëpërmjet kombinimit të këtyre opsioneve. Më të shprehur, janë operatorët që ofrojnë shërbimin në kuadër të një rajoni ose Kompani Rajonale të Mbeturinave (KRM). Për të ushtruar veprimtarinë, secili operator duhet të jetë i licencuar për menaxhimin e mbeturinave, pranë ministrisë përkatëse Aktualisht ekzistojnë 15 operatorë të ndryshëm që ofrojnë shërbime të grumbullimit të mbeturinave në Kosovë. Në pjesën më të madhe të komunave të Kosovës mbeturinat grumbullohen nga kompani rajonale të mbeturinave (KRM), ndërsa grumbullimi i mbeturinave bëhet edhe nga ndërmarrje publike lokale (NPL), kompani private si dhe në disa komuna ofrohet shërbimi në kuadër të organizimit komunal.




Figura 1. Operatorët që ofrojnë shërbimet e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë (CEDE KS, n.d.)

4.4 Deponitë

Mbeturinat e grumbulluara nga këta operatorë transportohen për deponim të përkohshëm nëpër transfer stacione ose direkt në deponit qendrore për deponim të përhershëm. Aktualisht ekzistojnë 8 lokacione – deponi nëpër të cilat bëhet deponimi i përhershëm i mbeturinave. Ekzistojnë 3 transfer stacione, kurse planifikohet të ndërtohen edhe 5 transfer stacione tjera. Sipas Strategjisë, Deponia e Pejës do të zgjerohet, ndërsa një deponi e re do të identifikohet për t'i shërbyer rajonit të Prishtinës. Deponit e tjera rajonale synohet të avancohen, disa të vazhdojnë të funksionojnë ose të mbyllen dhe rehabilitohen

4.4.1. Deponit ilegale

Tjetër tregues i rëndësishëm i gjendjes së menaxhimit të mbeturinave është edhe numri i deponive ilegale në territorin e një komune. Termi 'deponi ilegale' përkufizohet si çdo pikë jashtë deponive të përcaktuara në nenin 33 të Ligjit Nr. 04/60 për Mbeturina. Në 2 vitet e fundit, trendi i deponive ilegale është në rënie. Kjo për shkak të integritetit të ekonomive familjare në shërbim. Për nga kategorizimi i madhësisë, deponit ilegale ndahen në 3 grupe:

- 'deponi e vogël' nënkupton sasi të mbeturinave 1-5 thasë të 200 litrave,
- 'deponi e mesme' nënkupton sasi të mbeturinave 5-20 thasë të 200 litrave,
- 'deponi e madhe', nënkupton sasi të mbeturinave mbi 20 karroca.

(Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2012)

5. Ndotja e ajrit

Disa nga shkaqet për ndotjen e ajrit në Kosovë termocentralet me qymyr, trafiku, përdorimi i qymyrit nëpër shtëpi për ngrohje dhe gatim, si dhe industria. Ndotja e ajrit paraqet grumbullimin e atyre substancave të rrezikshme në atmosferë që ato substance ju rrezikojnë jetën e njerëzve dhe të gjallesave tjera. Zhvillimi i industrisë dhe përdorimi i shumtë i makinave bënë që ajri që ne e thithim është shumë i ndotur dhe sidomos në zonat urbane që aty është popullsia edhe më e madhe.

Ajri që ne e thithim është i mbushur me elemente shumë të rrezikshme për jetën si CO₂, Pb etj. Kjo bën që numri i sëmundjeve të jetë shumë i madhe dhe sëmundjet të jenë më rrezik të madhë për jetën e njeriut. Termocentralet e Kosovës vazhdojnë të jenë ndër ndotësit më të mëdhenj në Evropë. Termocentralet e Kosovës kanë nevojë për investime shtesë, vendosja e filtrave në termocentralin Kosova B, do të ndikojë dukshëm në uljen e nivelit të ndotjes. Filtrat e termocentraleve më qymyr nuk janë ndërruar për një kohë të gjatë, prandaj ajri është më i keq. Kostot për filtra të mirë shkojnë në miliona. Deri tani nuk ka pasur para nga buxheti publik për filtra të rinj. Kosova ka pasur probleme të vazhdueshme sa i takon ndotjes së mjedisit, nga termocentralet Kosova A dhe Kosova B.

6. Ndotja e ujit

Ndotja e ujit paraqet hedhjen e materieve kimike, biologjike dhe fizike nëpër sasi të mëdha të ujit, të cilat materie shkatërrojnë cilësinë e gjallesave në të dhe që e shpenzojnë atë Kosova ka resurse të kufizuara ujore, qoftë ujërave sipërfaqësor qoftë atyre nëntokësor, prandaj mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i tyre është me rëndësi jetike për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit. Ujërat e zeza urbane, bujqësia intensive dhe aktivitetet e ndryshme industriale aktualisht janë faktorët kryesorë që po kërcënojnë kualitetin e resurseve ujore përmes rritjes së shkarkimeve të ndotësve të ndryshëm në këto ujëra. Ndotja më e madhe që u bëhet ujërave në Kosovë vjen nga ujërat e zeza të pa trajtuara. Rrjetet e kanalizimit të ndërtuara të gjitha përfundojnë në lumenj e jo në impiantet e ujërave të zeza. Kosova aktualisht ka në funksion tri impiante për trajtimin e ujërave të zeza: Prizren, Skenderaj dhe Junik. Sipas informacioneve zyrtare, së shpejti pritet të hyjnë në funksion edhe impiantet në Pejë e Gjakovë. Ndotja e ujërave përpos dëmit financiar ka dëshmuar se ka krijuar dëme serioze edhe në shëndetin e njerëzve. Mënyra më e mirë për parandalimin e ndotjes së ujit është që të mos hedhim mbeturina dhe materie të tjera kimike të dëmshme në burimet tona të furnizimit me ujë. (KALLXO.com, 2022) (Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, 2015).

7. Ndotja e tokës

Plehrat kimike, Pesticidet dhe mbetjet industriale si faktorë kryesorë dëmtojnë tokën, ulin produktivitetin dhe ndikojnë negativisht në prodhimin bujqësor. Toka e ndotur posedon një rrezik të jashtëzakonshëm për njeriun. Ajo ndikon në shëndetin tone qofte në kontakt të drejtpërdrejtë me të ose nëpërmjet thithjes se avujve që i lëshojnë këto toka. Ndotja mund të depërtojë deri në ujërat nëntokësore, ujëra që i shfrytëzojmë ne për pirje. Këto gjera mund të qojnë deri në përhapjen e sëmundjeve të renda. Efektet e ndotjes së tokës varen edhe nga lloji i ndotjes. Shumica e ndotësve të saj, si plumbi, kromi e metale të renda, së bashku me kimikatet bujqësore, janë kancerogjene dhe rrezikojnë në paraqitjen e shume sëmundjeve kronike të njeriu, si p.sh: koke dhimbje, lodhje, dëmtim të syve, irritim të lëkurës, etj. Në raste të renda mund të qojë deri në vdekje. (Eureka24, 2018) (Velesin Peçuli, Albert Kopali, 2016)

Burimet kryesore të ndotjes së tokës janë:

- Prurjet rastësore të ndotësve nëpërmjet shirave, të cilët mund të transportojnë ndotës të ndryshëm të shkarkimeve sidomos në afërsi të zonave industriale.
- Prurje nga ujërat e rrjedhjeve të shkarkimeve urbane.
- Përdorimi i plehrave kimike ata përmbajnë jone minerale toksike.

8. Mbrojtja e mjedisit nga ndotja

Në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës kemi Departamentin për mbrojtjen e mjedisit, që për mision ka: Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit si një pasuri e vlefshme për popullin e Kosovës. Mbrojtja e mjedisit nga efektet e dëmshme të ndotjes dhe vizon: Një mjedis i pastër, i shëndetshëm dhe i mbrojtur mirë që mbështet një shoqëri dhe ekonomi të qëndrueshme. Po ashtu mbrojtja e mjedisit bëhet edhe me ligj LIGJI Nr. 03/L-025 LIGJI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT. Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; Më qëllim të krijimit të standardeve mjedisore në Kosovë në harmoni me ato të Bashkimit Evropian, (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2009)

9. Parandalimi i ndotjes së mjedisit

Ka shumë masa paraprake që duhen marrë në nivel individual, social dhe global për të parandaluar ndotjen e mjedisit dhe për të reduktuar ndotjen ekzistuese. Këtu janë hapat që mund të ndërmerren për të reduktuar ndotjen e mjedisit:

- Përdorimi i Burimeve të Rinovueshme të Energjisë:
- Menaxhimi dhe riciklimi i mbetjeve:
- Mbrojtja dhe rritja e zonave të gjelbra
- Mbrojtja e burimeve ujore:
- Transporti miqësor ndaj mjedisit
- Ndërgjegjësimi i publikut:

Ju gjithashtu mund të inkurajoni vendin tuaj të punës dhe rrethin për të parandaluar ndotjen e mjedisit Vitet e fundit është rritur edhe vetëdija dhe reagimi publik për nevojën e ruajtjes së biodiversitetit brenda kufijve të normave natyrore. (Shallari, 2018).

10. Metodologjia e hulumtimit

Metodologjia është një ndër pjesët më të rëndësishme të këtij hulumtimi. Gjatë këtij punimi janë analizuar më kujdes të veçantë përgjigjet. Kam hulumtuar më kujdes se sa të informuar janë qytetarët rreth ndotjes së mjedisit në shëndetin tonë dhe sa shumë rëndësi i japin në përgjithësi mbrojtës së mjedisit. Në këtë studim janë përdorur vetëm kërkimet primare.

Hulumtimi primar bazohet në terren dhe si metodë hulumtuese është përdorur vizita dhe takimi me qytetarë duke përfshirë grup moshë të ndryshme.

11. Rezultatet e hulumtimit

Cilat janë burimet kryesore të ndotjes së ajrit në Kosovë?

54 responses



Grafikoni 1

Si ndikon industria e tëngjillit në ndotjen e mjedisit në Kosovë?


54 responses



Grafikoni 2

Çfarë ndikimi ka ndotja nga trafiku automobilistik në cilësinë e ajrit?


54 responses



Grafikoni 3

Cilat janë pasojat e ndotjes së ujit në lumenjtë e Kosovës?


54 responses



Grafikoni 4

Si ndikon ndotja në biodiversitetin e Kosovës?

54 responses




- Ndotja shkatërron habitate natyrore dhe dëmton speciet e rrezikuara.
- Disa speciet rezistente mund të mbijetojnë, duke ndryshuar ekosistemet lokale.
- Masat për ruajtjen e biodiversitetit janë të pamjaftueshme, thonë disa.

Grafikoni 5

Cilat janë masat e marra nga qeveria për reduktimin e ndotjes së mjedisit?

54 responses




- Qeveria ka miratuar ligje dhe rregullore për mbrojtjen e mjedisit.
- Disa mendojnë se masat janë të pamjaftueshme dhe nuk zbatohen në praktikë.
- Projekte ndërkombëtare dhe OJQ-të kanë ndihmuar në përmirësimin e masave.

Grafikoni 6

Si është niveli i riciklimit të mbeturinave në Kosovë?

54 responses




- Riciklimi është shumë i ulët, me pak ndërmarrje të përfshira.
- Ndërgjegjësimi publik për riciklimin po rritet, por infrastruktura mungon.
- Disa qytete kanë nisur projekte pilot për ndarje të mbeturinave.

Grafikoni 7

Cilat janë efektet shëndetësore të ndotjes së ajrit për popullatën?

54 responses




- Ndotja e ajrit lidhet me sëmundje të frymëmarrjes dhe kancer.
- Disa argumentojnë se rritja e vdekshmërisë nga ndotja është alarmante.
- Ndikimi i ndotjes së mjedisit tek fëmijët është një shqetësim madhor.

Grafikoni 8

Sa i rrezikuar është Prishtina nga ndotja e ajrit?

54 responses




- Prishtina është një nga qytetet më të ndotura në Evropë.
- Përmirësimet infrastrukturore, si zgjerimi i rrjetit të transportit publik, ndihmojnë.
- Disa mendojnë se rritja e ndërgjegjësimit qytetar për përdorimin e biçikletave ka sjellë përmirësime.

Grafikoni 9

Cili është roli i OJQ-ve në mbrojtjen e mjedisit në Kosovë?

54 responses




- OJQ-të janë thelbësore në sensibilizimin dhe mbrojtjen e mjedisit.
- Disa mendojnë se ndikimi i OJQ-ve është i kufizuar për shkak të mungesës së fondeve.
- Bashkëpunimi i OJQ-ve me qeverinë ka sjellë disa suksese të pjesshme.

Grafikoni 10

Si ndikon ndotja në ndryshimet klimatike në Kosovë?

54 responses




- Industria e rëndë dhe burimet e ndotjes kontribuojnë në ngrohjen globale.
- Disa besojnë se Kosova po përballet me sfida të mëdha për të zbutur efektet e ndryshimeve klimatike.
- OJQ-të dhe disa aktivistë thonë se duhet një përkushtim më i madh ndaj energjisë së rinovueshme.

Grafikoni 11

A ka kapacitete të mjaftueshme trajtimi për ujërat e ndotura?

54 responses




- Kapacitetet ekzistuese janë të pamjaftueshme dhe të papërditësuar.
- Përmirësimet e fundit kanë ndihmuar në disa qytete, por situata mbetet kritike.
- Disa besojnë se duhet më shumë investime në infrastrukturë.

Grafikoni 12

Si ndikon djegia e mbeturinave në ndotjen e ajrit dhe tokës?

54 responses




- Djegia e mbeturinave kontribuon në ndotjen e ajrit dhe çlirimin e gazeve të dëmshme.
- Mungesa e politikave për menaxhimin e mbetjeve shton këtë problem.
- Alternativat si kompostimi dhe riciklimi janë të pamjaftueshme.

Grafikoni 13

Çfarë ndikimi kanë deponitë ilegale të mbeturinave në mjedis?

54 responses




- Deponitë ilegale janë një problem madhor që ndikon në tokën dhe burimet e ujit.
- Shumë njerëz besojnë se ndëshkimet për krijimin e tyre janë të pamjaftueshme.
- Disa zona kanë nisur të pastrohen me projekte të financuara nga donatorë ndërkombëtarë.

Grafikoni 14

Si po i përballon Kosova sfidat e ndotjes së mjedisit në përputhje me standardet evropiane?

54 responses



Grafikoni 15

12. Diskutimi i rezultateve

Në këtë punim diplome kemi analizuar njohurinë e qytetarëve rreth ndikimit të ndotjes së mjedisit në Kosovë. Unë, në këtë hulumtim kuptova njohuritë e qytetarëve rreth temës për ndotjen e mjedisit.

Një ndër pyetjet hulumtuese ishte: “Cilat janë burimet kryesore të ndotjes së ajrit në Kosovë?” dhe kuptova që qytetarët kanë nevojë ende për njohuri rreth gjendjes së ndotjes së mjedisit.

Për ta kuptuar edhe më shumë interesimin e qytetarëve rreth kësaj pyetje parashtrova edhe disa pyetje tjera që të grumbulloja sa më shumë informacione rreth njohurive të tyre për ndotjen e mjedisit. Pyetjet janë parashtruar qytetarëve të të gjitha grup moshave. Në këto pyetje janë përgjigjur përafërsisht 54 qytetarë. (Baloku, 2024)

13. Përfundime dhe rekomandime

Si përfundim nga ky hulumtim në terren dhe rezultatet që i nxora do të jap këtë rekomandime.

Rekomandimi në radhë të parë është që do të doja që qytetarët të jenë më shumë të interesuar rreth shëndetit dhe mirëqenies së tyre me rastin e ndotjes së mjedisit ku ata jetojnë.

Në radhë të dytë do t'ju rekomandoja vetëdijesimin dhe ndërgjegjësimin: Të organizohen fushata edukative për qytetarët, duke i informuar ata mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe mënyrat për të reduktuar mbetjet nga ndotja dhe ndotjen në përgjithësi.

Duke e zbatuar këto rekomandime, Kosova mund të përmirësojë cilësinë e mjedisit dhe të sigurojë një të ardhme më të shëndetshme për brezat e ardhshëm.

Konkluzionet në këtë hulumtim tregojnë që qytetarët duhet ti kushtojnë më shumë rëndësi ndikimit të ndotjes të mjedisit në shëndetin e tyre në një periudhe kohore më të hershme dhe të jenë të vetëdijshëm rreth ndotjes së mjedisit që i rrethon.

Në fund si përfundim, mbështetur në rezultatet që unë nxora nga ky studim ndotja e mjedisit në Kosovë është një çështje shqetësuese që kërkon vëmendje dhe veprim të menjëhershëm. Për të adresuar këtë situatë, është thelbësore që autoritetet lokale dhe qendrore të hartojnë politika efikase dhe të angazhohen për edukimin e qytetarëve mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit. Vetëm përmes bashkëpunimit dhe veprimeve të koordinuara, mund të krijojmë një të ardhme më të pastër dhe më të qëndrueshme për Kosovën.

14. Referencat

- Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. (2015). *Raport për gjendjen e ujërave në Republikën e Kosovës*. Prishtinë: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor.
- Baloku, V. (2024). *Ndotja e mjedisit në Kosovë*. Peja: Universiteti "Haxhi Zeka". Retrieved from <https://forms.gle/FLiyf9b2DdY5YieX9>
- Bektashi, A. (n.d.). *Qendra Rajonale e Mjedisit (REC)*.
- CEDE KS. (n.d.). Retrieved from <https://cede-ks.org/ëp-content/uploads/2022/06/K%C3%8BNDV%C3%8BSHTRIMI-I-QYTETAR%C3%8BVE-LIDHUR-ME-MENAXHIMIN-E-MBETURINAVE.pdf>
- Eureka24. (2018, Prill 3). *Çka është ndotja e tokës?* Retrieved from Eureka24 Online: <https://eureka24online.wordpress.com/2018/04/03/cka-eshte-ndotja-e-tokes-dhe-si-ndodh-ajo/>
- KALLXO.com. (2022, Maj 18). *Kosova, vendi i eksportit të ujërave të kanalizimeve*. Retrieved from KALLXO.com: <https://kallxo.com/gjate/kosova-vendi-i-eksportit-te-ujerave-te-kanalizimeve/>
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2009, Prill 06). *LIGJI NR.03/L-025 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT*. Retrieved from Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2631>
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2012, Qershor 29). *LIGJI Nr. 04/L-060 PËR MBETURINA*. Retrieved from Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2829>
- Shallari, P. D. (2018). *Vlerësim dhe menaxhim mjedisi*. Tiranë.
- Velesin Peçuli, Albert Kopali. (2016). *Ekologjia*. Tiranë.